



Prishtinë, 3 nëntor 2021  
Kodi i ZRRE-së: V\_1449\_2021

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Bazuar në:

- Dispozitat e Nenit 9 paragrafi 1 nën-paragrafi 1.7, Nenin 15, Nenin 25, Nenin 26 par. 1 nënpar. 1.2, Nenin 47 dhe Nenit 48 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë Nr. 05/L-084;
- Dispozitat e Nenit 19 të Ligjit për Energjinë Nr. 05/L-081;
- Dispozitat e Nenit 18 dhe nenit 19 të Ligjit për Energjinë Termike Nr. 05/L-052;
- Rregullën për Vendosjen e Çmimeve të Energjisë Termike;
- Vendimin për NQ Termokos SH.A., Nr. V\_1448\_2021 Të Hyrat e Lejuara Maksimale (MAR), dhe
- Aplikacionin/Kërkesën e Ndërmarrjes Publike – Ngrohtorja e Qytetit (NQ) Termokos SH.A., për shqyrtimin e të Hyrave Maksimale të Lejuara dhe Tarifave të Energjisë Termike (Ngrohjes), të dorëzuar me datë 16 gusht 2021, në kuadër të Shqyrtimit të Tarifave të Energjisë Termike me dokumentacionin relevant sqarues ,

në seancën e mbajtur me datë 03 nëntor 2021 nxori këtë:

## V E N D I M

- I. **APROVOHEN** tarifat e energjisë termike për konsumatorët fundorë të Ngrohtores së Qytetit (NQ) Termokos SH.A. për sezonin e ngrohjes 2021/2022.
- II. Struktura e tarifave të energjisë termike për NQ Termokos sh.a., për sezonin e ngrohjes 2020/2021 është dhënë në Tabelën 1 më poshtë:

Tabela 1: Struktura e tarifave të energjisë termike për NQ Termokos SH.A. – sezoni 2021/2022:

TARIFAT E ENERGISË TERMIKE TË NQ TERMOKOS - Sezoni 2021/2022			
<b>A: TARIFAT E ENERGISË TERMIKE ME MATJE</b>			
Komponentët e tarifës	Njësia	Vlera	
Tarifa Mujore për Kapacitetin Termik (Komp. fikse)	[€/kW/muaj]	0.78	
Tarifa për Furnizim /Konsum të En. Term. (Komp. variable)	[€/MWh]	36.25	
<b>B: TARIFAT E ENERGISË TERMIKE PA MATJE</b>			
Komponentët e tarifës	Njësia	Konsumat. shtëpijak	Konsumat. Kom&Inst.
Tarifa mujore për Kapacitetin Termik (komponenta fikse)	[€/m <sup>2</sup> për muaj]	0.11	0.14
Tarifa për Furnizimin /Konsumin e En. Term. (komp. variable)	[€/m <sup>2</sup> për muaj]	0.65	0.81
Tarifa totale për konsumatorët pa matje	[€/m <sup>2</sup> për muaj]	0.76	0.95



- III. Duke marrë parasysh gjendjen aktuale lidhur me matjen e furnizimit/konsumit të energjisë termike, tarifave të përcaktuara në dispozitivin nën pikën II. të këtij Vendimi zbatohen për faturim për rastet tipike si në vijim:
- Për objektet, nënstacionet e të cilëve janë të pajisur me matës funksional të energjisë termike, dhe që janë në pronësi ose në shfrytëzim të një konsumatori, për faturim zbatohen tarifave me matje – Tabela 1A
  - Për objektet e banimit kolektiv që janë në pronësi ose në shfrytëzim të disa konsumatorëve, nënstacionet e të cilëve janë të pajisur me matës funksional të energjisë termike dhe instalimet e brendshme të ngrohjes qendrore në objekt mundësojnë matjen e konsumit në nivel apartamenti, për faturim zbatohen tarifave me matje – Tabela 1A.
  - Për objektet, nënstacionet e të cilëve nuk janë të pajisur me matës funksional të energjisë termike, dhe për objektet e përshkruara nën pikën (2) në të cilat instalimet e brendshme të ngrohjes qendrore pamundësojnë matjen e konsumit në nivel apartamenti, për faturim do të zbatohen tarifave “normative”, sipas sipërfaqes ngrohëse të konsumatorit, – Tabela 1B.
- IV. NQ Termokos sh.a. duhet ta publikojë strukturën e tarifave të energjisë termike siç është përcaktuar në Tabelën 1 të këtij Vendimi, brenda pesë (5) ditëve të punës pas shpalljes dhe publikimit të këtij vendimi në faqen elektronike të ZRRE-së, në së paku një prej gazetave ditore me qarkullim më të gjerë në Kosovë.
- V. Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) ka të drejtë, që të auditojë regjistrat e kontabilitetit dhe faturat e NQ Termokos, për të verifikuar realizimin e të dhënave të paraqitura nga NQ Termokos SH.A.
- VI. Ky vendim do të zbatohet nga ndërmarrja NQ Termokos SH.A., duke filluar nga 15 tetor 2021 deri në shqyrtimin e ardhshëm tarifor.

## ARSYETIM

- Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me datë 16 gusht 2021 nga NQ Termokos SH. A., ka pranuar aplikacionin/kërkesën për shqyrtimin dhe aprovimin e të Hyrave Maksimale të Lejuara dhe tarifave të energjisë termike.
- ZRRE me rastin e përcaktimit të tarifave të energjisë termike, ka marrë parasysh dokumentet e nxjerra dhe të publikuara në ueb faqen zyrtare të ZRRE-së, si në vijim:
  - Të dhënat dhe informatat e dorëzuara bashkangjitur me kërkesën për shqyrtimin e të Hyrave Maksimale të Lejuara dhe tarifave të energjisë termike, të datës 16 gusht 2021;
  - Komentet me shkrim lëshuar nga ZRRE me 8 shtator 2021, ku janë specifikuar kërkesat për korrigjim, përmirësim dhe plotësim të të dhënave dhe informatave të dorëzuara bashkangjitur me kërkesën e datës 16 gusht 2021;
  - Të dhënat dhe informatat e korrigjuara dhe të plotësuara sipas komenteve me shkrim të ZRRE-së, ri-dorëzuar nga NQ Termokos SH.A., me datë 17 shtator 2021;
  - Raportin për Konsultim Publik: Vlerësimet Preliminare për Përcaktimin e të Hyrave Maksimale të Lejuara për NQ Termokos – sezoni i ngrohjes 2021/2022;




- Komentet me shkrim të pranuar gjatë periudhës së konsultimit publik (7 tetor – 22 tetor 2021);
- Përgjigjen e ZRRE-së ndaj komenteve me shkrim të pranuar gjatë periudhës së konsultimit publik;
- Raportin Final: Përcaktimi i të Hyrave Maksimale të Lejuara për NQ Termokos SH.A. – sezoni i ngrohjes 2021/2022; dhe
- Raportin final për Përcaktimin e Tarifave të Energjisë Termike për NQ Termokos SH.A. – sezoni i ngrohjes 2021/2022.
- Bordi i Rregullatorit pas vlerësimit dhe analizimit të raporteve relevante dhe pas shqyrtimit të komenteve të pranuar nga palët, dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

VII. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.

VIII. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së, dhe i njëjti do të publikohet në ueb faqen zyrtare të ZRRE-së.

**Këshillë juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve, nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të Vendimit në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.


**Bordi i ZRRE-së:**

  
Ymer Fejzullahu, kryesues

  
Selman Hoti, anëtar

  
Izet Rushiti, anëtar

  
Lutfiye Dervishi, anëtare

  
Gani Buçaj, anëtar

**Bashkangjitur:** Raporti Rregullativ: Përcaktimi i tarifave për NP Termokos sh.a. – sezoni i ngrohjes 2021/2022

**Vendimi iu dërgohet:**

- Palës; dhe
- Arkivit të ZRRE-së